



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1204 Prot.

Rrëshen më, 27 . 03 . 2023

R A P O R T
PËR PUNËN/VEPRIMTARINË, E KËSHILLIT BASHKIAK
MIRDITË PËR VITIN 2022.

Paraqitur për njohje e miratim, në mbledhjen e datës 31 Mars 2023, të Këshillit bashkiak Mirditë.

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisjes bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë.

Këshilli Bashkiak Mirditë, gjatë vitit 2022, është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur, për një shërbim sa më cilësor ndaj komunitetit.

Prioritare kanë qenë vendimet që i kushtoheshin procesit të rindërtimit pas tërmetit të datës 26.11.2019. Këshilli ka marrë dhe vendime, që i kushtoheshin familjeve me probleme të thella sociale, eliminimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Ka marrë vendim çdo muaj për dhënie ndihmë financiare, për familje, nga fondi i kushtëzuar, për bllok-ndihmën deri në 6%, si më poshtë :

Nr.	Muaji	Ndihmë ekonomike për familje nga Fondi i kushtëzuar 6 %. (Nr. i familjeve)
1	JANAR	110
2	SHKURT	116
3	MARS	122
4	PRILL	122
5	MAJ	124
6	QERSHOR	117
7	KORRIK	114
8	GUSHT	111
9	SHTATOR	109
10	TETOR	108
11	NËNTOR	108
12	DHJETOR	-

Në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16. 12. 2019 Këshilli i Bashkisë Mirditë, ka marrë vendime të rëndësishme për periudhën Janar - Dhjetor 2021 si,

2 Vendime të këshilli bashkiak, Për riparimin e mjediseve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, (pallate) në qytetet Rrëshen, Rubik, që kanë dhënë një impakt shumë pozitiv te qytetrët.

Për reduktimin e taksës së ndërtesës dhe tarifave vendore për objektet e prekura nga termeti për vitin 2021.

Krahas këtyre vendimeve kemi miratuar vendime për:

- ✚ Shtesë dhe ndryshime të buxhetit për vitin 2022 me qëllim rritjen e efikasitetit të burimeve financiare.
- ✚ Për buxhetin e vitit 2023 dhe projekt buxhetin afatmesëm të Bashkisë Mirditë për vitet 2023- 2025.
- ✚ Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkin Mirditë për vitin 2023.
- ✚ bursat për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe konviktet e shkollave të mesme profesionale, për vitin shkollor 2022-2023.
- ✚ Gjithashtu Këshilli ka marrë dhe disa vendime që i përkasin mbarëvajtjes së punës së tij.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2022, janë marrë 120 vendime gjithsej në Këshillin Bashkiak Mirditë.

Vlen për t'u theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak Mirditë kanë qenë konformë ligjeve dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Për vendimet e marra nga ky këshill për vitin 2022, Institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur pozitivisht, për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre, për vendimet e marra me përjashtim të:

Nuk janë konfirmuar bazueshmëria ligjore nga institucioni i Prefektit 1 (një) vendim përkatësisht;

Vendimi nr. 98, datë 28. 10. 2022, (Kalim bazë materiale nga APPM-Mirditë tek Ujësjiellës Kanalizime sha. Mirditë).

Konfirmuar pjesërisht 1 (një) vendim përkatësisht;

Vendimi nr. 35, datë 31. 05. 2022. (ndryshim VKB 41, datë 19.04.2017, "Për caktimin e kufijve të pagave, të punonjësve të administratës së bashkisë Mirditë e institucioneve në varësi).

Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit, flasin qartë për bashkëpunimin e Këshillit me administratën e Bashkisë, për t'iu përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi, gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Bashkisë Mirditë.

Këshilli gjatë kësaj periudhe ka qenë mjaft aktiv, duke mbajtur mbledhjet e radhës, sipas tabelës së mëposhtme :

Muaji	Nr. i mbledhjeve	Mbledhje të Radhës	Mbledhje jashtë radhe	Mbledhje të Jashtëzakondshme
JANAR	1	1 (31.01.2022)	-	-
SHKURT	1	1 (28.02.2022)	-	-
MARS	1	1 (29.03.2022)	-	-
PRILL	1	1 (29.04.2022)	-	-
MAJ	1	1 (31.05.2022)	-	-
QERSHOR	1	1 (22.06.2022)	-	-
KORRIK	1	1 (27.07.2022)	-	-
GUSHT	2	1 (17.08.2022) 1 (24.08.2022)	- -	- -
SHTATOR	1	1 (28.09.2022)	-	-
TETOR	1	1 (28.10.2022)	-	-
NËNTOR	1	1 (30.11.2022)	-	-
DHJETOR	1	1 (13.12.2022)	-	-
GJITHËSEJ	13	13	-	-

- Vlen të përmendet, kontributi i anëtarëve të këshillit, që janë në përbërje të Komisioneve të Përhershme të këshillit bashkiak, ku veçojmë dhe falenderojmë;

1. Komisionin e Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit;

- ✚ Aleksandër LUSHA – kryetar, Endrik Simoni – Zv.kryetar, Pjetër Pjetri, Mark Prenga, Nikoll Prendi dhe Ndue Ceku; anëtarë.

2. Komisionin e Bujqësisë, Shëndetit Publik, Pyjeve dhe Ujrave;

- ✚ Aleksandër DOADAJ - kryetar, Aleksandër LUSHA - Zv.kryetar, Ndue Ceku dhe Nikolin Luli; anëtarë.

3. Komisionin i Shërbimeve Publike, Transportit dhe Infrastrukturës.

- ✚ Aleksandër DOADAJ - kryetar, Ndue Halili - Zv.kryetar, Adnan Dona dhe Nikolin Luli; anëtarë.

4. Komisionin i Mirëqënies Sociale, Barazisë Gjinore.

- ✚ Mirie Nikolli (Brozi), që ka qënë mjaft aktive dhe një nga veprimtaret më të mira në gjithë bashkitë e vendit.

Aktiviteti në faqen e facebook, të Këshillit Bashkiak Mirditë, për vitin 2022.

- ✚ Gjatë vitit **2022** janë zhvilluar, **9 mbledhje online në facebook.**
- ✚ Rendi i ditës, të mbledhjeve të këshillit bashkiak, janë publikuar **5 ditë para mbledhjes në facebook dhe web-in e bashkisë Mirditë.**
- ✚ Postime **65 (4,4% më shumë se në 2021)**

Historitë 0 (0%)

Mesatarja e reagimeve për postime

- ✚ 23 reagime për postim (**27,8% më shumë se në 2021**)
- ✚ Kemi arritur gjithsej **13 684 persona**, ose **33.9%** më shumë se në 2021. Gjithashtu viher re se rritja ka qënë konstante, duke filluar nga janari në dhejtor me tendencë rritje.
- ✚ Faqja ka gjithsej **863** ndjekës të të gjitha moshave, me një raport **24.7% femra dhe 75.3% meshkuj**. Ndjekësit vijnë nga gjithë Shqipëria si dhe nga diaspora, por përqendrimi është te ndjekësit që banojnë aktualisht në bashkinë Mirditë me **25.6% të ndjekësve, në Tiranë më 23.8%** e me rradhë. **83%** e ndjekësve janë nga Shqipëria.
- ✚ **Të gjitha vendimet e këshillit bashkiak, janë publikuar në poratlin vendime.al dhe web-in e bashkisë Mirditë dhe janë të aksesueshëm nga çdo qytetar pa pagesë.**

Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë vendimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe strehimin, prishjet shtëpive individuale në disa fshatra të njësisve administrative të Bashkisë Mirditë, të dëmtuara nga tërmeti me qëllim ndërtimet e tyre të reja dhe rikonstruksionin e objekteve publike si; riparimi ambjenteve të përbashkëta (pallate), në qytetet Rrëshen, Rubik faza e II & III, nga fondi i rindërtimit akorduar nga Qeveria Shqiptare.

Është pasuruar në faqen zyrtare të Bashkisë Mirditë, informacionet e Këshillit Bashkiak për publikun nëpërmjet kartelave/tabelave të mëposhtëme:

- Kryetari i Këshillit - kontaktet.
- Sekretari i Këshillit - kontaktet.
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak - kontaktet
- Kryetarët e Fshatrave të Bashkisë - kontaktet.
- **5 Rrregulloret e Këshillit Bashkiak.**
- Kalendar i Konsultimit Publik.
- Njoftimi i konsultimit publik.
- Vendim i miratimit të planit të aktiviteteve dhe buxhetit të këshillit (Plan+buxhet këshilli).
- Rregjistri i kërkesë ankesave.
- Rregjistri i brendshëm i peticioneve.
- Rregjistri i mbledhjeve të këshillit.
- Konsultime Publike.

Nga Sekretariati i Këshillit është vënë në zbatim kërkesat e ligjit për njoftimet publike (si në faqen zyrtare të Bashkisë, Drejtorëve të bashkisë), në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Mirditë, por në të ardhmen do të bëhet e mundur jo vetëm njoftimi në faqen e Bashkisë apo në media vendore por edhe njoftimeve e shpalljeve në të gjitha njësitë administrative e lagjet e qytetit, ku për këtë është e nevojshme mbështetja nga nëpunësit e njësive administrative.

Gjithashtu në çdo mbledhje plenare të radhës është lënë një hapësirë për pyetje nga komuniteti (kërkesa apo ankesa), që janë përcjellë përmes pyetjeve që kanë bërë Këshilltarët drejtuar administratës së Bashkisë, të cilat kanë marrë përgjigje të drejtëpërdrejtë nga administrata e bashkisë.

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar si dhe ligjit 146/2014, "Për konsultimin Publik" gjatë vitit 2022, (**Nëntor**), këshilli ka mundur të zhvillojë **10** dëgjesa publike, në **7** njësitë administrative të bashkisë dhe **3** në lagjet e qytetit Rrëshen.

Këshilli nëpërmjet faqes së tij online ka hapur një rubrikë të konsultimeve me publikun si një nga mënyrat e pjesëmarrjes së komunitetit për të përcjell shqetësimet e sygjerimet e tij.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen; gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e bashkisë, paketës fiskale, tjetërsimit dhe dhënies me qira të pronave, miratimi i standarteve e rregulloreve etj. me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimarrje të komunitetit.

Administratorët e lagjeve dhe të njësive administrative, kryesitë e fshatrave, këshillat komunitare, duhet të bëhen pjesë e organizimit e mbështetjes së dëgjësave publike, ku nëpërmjet posterave, anketave të ndryshme do të bëhet e mundur tërheqja e mendimit të komunitetit dhe pjesëmarrja e tyre në vendimarrje.

Del si detyrë që çdo këshilltar; për aktet normative, të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Për sa më sipër, vlerësojmë përvojën pozitive dhe ndërkohë kërkojmë plane tuaja për dëgjesa në zonat ku banoni apo jeni caktuar për të kryer detyrën e këshilltarit.

Falenderimet, shkojnë për;

- Falenderojmë për punën e palodhur, administratën e Bashkisë Mirditë dhe mbështetjen që i kanë dhënë Sekretariatit të Këshillit dhe në veçanti Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore, Agjencinë e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Kulturës, Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe

Emergjencave, Protokollin dhe Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun.

- Falenderojmë, Asistenten e këshillit bashkiak, Znj. Lindita Zefi, për ngarkesën dy fishe e pa shpërblim, për punën, korrektesën dhe përkushtimin e saj, në mbarëvajtjen e dokumentimin e mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme dhe të Këshillit Bashkiak Mirditë.
- Falenderojmë për asistencën teknike dhe operacionale Z. Hekuran Koka & Bukurosh Onuzi, koordinatorë të projektit “Bashki të Forta”.

Ndërveprimi i Këshillit Bashkiak me qytetarët, në rrjetet sociale, të nxjerra në mënyrë garfikike, bashkëlidhur këtij raportit.

Faleminderit !

Hartuan raportin:

KRYETAR

Pjeter PJETRI



SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



Mbulimi

Compare your reach from this period to the previous one.

See more about your content performance

Facebook Page reach ⓘ

Mbulimi me pagesë ⓘ

13 684 ↑ 33.9%

0 0%

Daily

Cumulative

20.0 mijë

15.0 mijë

10.0 mijë

5.0 mijë

0

21 Jan

2 Mar

11 Pri

21 Maj

30 Qer

9 Gush

18 Sht

28 Tet

7 Dhj



Facebook Page reach



Facebook Page reach

1 Jan 2022 - 31 Dhj 2022

1 Jan 2021 - 31 Dhj 2021

863

Age & gender ①

